



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER ARDJANA A. MEDIU
ADRESA Rruga 'Ismail Qemali', Pall
Nr.11, Kati Nr.2, 1010, Tiranë
TEL: 694041500

MARRËVESHJE SIGURUESE


Nr. repertori: 2370

Nr. koleksioni: 835

Tirane më 02/05/2024

Ligjet referuese:

- Liqji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- Liqji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- Liqji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2024050620105420897

*Akti notarial përbëhet nga 9 fletë



A2024050620105420897

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NR. 2370 REP
NR. 833 KOL.

MARREVESHJE E BARREVE SIGURUESE

Sot, me date 02.05.2024, para meje noter Amlion A. Hedic, me zyre notoriale në adresën:
Rr. Basmil Qemali, Tirane, u paraqit palët kontraktuese, si më poshtë vijon:

BARREMARRESI: BBSH - Banka e Bashkuar e Shqiperise SH.A., me seli ne Rrugën "Dritan Hoxha", Ndertesa nr. 11, Hyrja 3, Tirane, me License Bankare nr. 03 date 11.01.1999 dhe NIPT J91811004Q, perfaqesuar nga **Ilir Çekiri**, Drejtor Ekzekutiv, lindur me 20.05.1981 ne Tirane me leternjoftim nr. 035649706 e nr. personal I10520182S, banues ne Tirane dhe **Alketa Martini**, Drejtor i Departamentit të Korporatave dhe Supervisor i Departamentit të Individëve, lindur ne Tirane me 30.11.1972, me leternjoftim nr. 036155017 dhe nr. Personal H26130051K, banuese ne Tirane.

DHE

BARREDHENESI: **Z Benon Dede**, i biri i Dhimitr-it, lindur me 10/02/1958 ne Tirane, mbajtes i leternjoftimit me numer personal F80210342N, dhe nr leternjoftimi 039227545, banues ne Rrugë "Abdyl Frasheri", Njesia Administrative Nr. 5, Tirane, madhor me zotesi te plete per te vepruar; dhe

Alma Dede, e bija e Dalip-it, lindur me 22/04/1966 ne Tirane, mbajtese e leternjoftimit me numer personal G65422130K, dhe nr leternjoftimi 033840467, banuese ne Rrugë "Abdyl Frasheri", Njesia Administrative Nr. 5, Tirane, madhore me zotesi te plete per te vepruar;

Barredhenesi ka rene dakord te jape nje barre siguruese mbi pasurite e tij te luajtshme qe pershkruhen ne vijim si garanci per financimin qe shoqeria tregtare **Tirana Auto**, (Klienti) ka marre nga BBSH per blerje e 170 automjetete tip Mitsubishi L200 2.5 GLS Double Cab Pick Up 4WD, sipas Preforma Invoice e dates 27/02/2024 ne shumen **583.107.000 all/-** (peseqind e tetedhjete e tre million e njeqind e shtate mijë leke shqiptare), nepermjet Marreveshjes se Financimit dhe Nr. 2369 Rep. Nr. 834 Kol. date 02.05.2024, quajtur "Financimi" ketej e tutje. Me qellim garantimin e detyrimeve qe rrjedhin nga kjo marreveshje financimi dhe ne lidhje me kete ai ka marre persiper t'i paguaje BBSH te gjitha detyrimet qe lidhen me shlyerjen ("Detyrimi").

- (1) BBSH eshte dakort me kete propozim dhe eshte gjithashtu dakort ta jape financimin, termi i te cilit perdorur ketu do te perfshije secilin dhe te gjitha detyrimet e cdo lloji te Barredhenesit (ose te ndonje ortakerie, sindikate, shoqate, joint venture ose grup tjeter pjesetar i te cilit eshte Barredhenesi, ketej e tutje se bashku quajtur "Ortakeria") qe rrjedhin nga leshimi prej BBSH i letrave te kredise, garancive, financimeve, produkteve te tjera qe lidhen me kontrata, veprime te ligjit ose ndryshe, absolute ose te varura, te terthorta, te likujduara ose jo, dhe te marra persiper prej Barredhenesit si pergjegjes kryesor, dorezanes, garant ose ndryshe.
- (2) Si garanci per shlyerjen e shumes se mbuluar nga Financimi sipas marreveshjes, Barredhenesi ka marre persiper te krijoje nje barre siguruese mbi disa pasuri te tij per BBSH-n.
- (3) Palet deshirojne te reduktojne me shkrim kushtet qe udheheqin kete barre siguruese.

TANI, PER KETO ARSYE, KJO MARREVESHJE DESHMON SI VIJON:

1 Barra Siguruese

1 Duke konsideruar qe BBSH, me kerkesen e Barredhenesit, ka rene dakort per te dhene financimin, Barredhenesi ketu signron dhe ngarkon te gjitha pasurite e tij te luajtshme te tashme dhe te ardhme perfshire



A2024050620105420897

pretendime dhe te arketueshme, dhe me vecanerisht pershkruar ne Nenin 5(1) ketu (referuar ketu si "Pasuria e Barresuar") me qellimin qe mjeti i sigurimit i krijuar ketu te qendoje i bllokuar dhe i barresuar per BBSH-n.

2

2 Dhenia e Financimi

Barredhenesi nuk do te perdore sherbime bankare ose financiare prej asnje banke ose institucion finanziar, pa marre me pare pelqimin e BBSH.

3 Pagesa

Ripagimi i shumes se mbuluar nga financimi do te jete sipas kushteve te rena dakort midis paleve.

- (1) Pavaresisht nga cfare perfshihet ne nen-piken (1) me lart dhe pavaresisht nga Liste pagesa e cituar aty, eshte rene shprehimisht dakort dhe eshte kuptuar se Barredhenesi do te paguaje menjehere, me kerkesen me shkrim te BBSH, te gjithe detyrimin e tij ndaj BBSH ne kohen e kesaj kerkesa bashke me tarifat e sherbimit, shpenzimet dhe te gjitha parate e tjera, demshperblime ose te tjera perfshire shpenzimet legale te cdo lloji, vullnetare ose jo, te drejtperdrejta ose te terthorta, absolute apo te varura, te likujduara ose te palikujduara, detyrime bashke me te tjeret ose vetem, te rritura ose jo me kalimin e kohes apo te shuara dhe me vone te rritura ose jo, te krijuara apo te hasura, dhe te gjitha detyrimet e cdo natyre qe i takojne BBSH sipas Marreveshjes me Barredhenesin, tanj ose ne te ardhmen.
- (2) Ne qofte se Barredhenesi kryen nje shkelje te ndonje kushti te Marreveshjes se tij me BBSH-n ne lidhje me ripagimin e detyrimeve ndaj BBSH, Barredhenesi do t'i paguaje BBSH, pervec shumave te permendura ne (1) me lart, 2% te Detyrimit si komision likujdimi.

4 Garanci per Pasurine e barresuar

Eshte dekluaruar ketu se Pasuria e Barresuar eshte prone absolute e Barredhenesit dhe, subjekt i Nenit 6(2)(b) ketu, ne diskrecionin e plete te Barredhenesit dhe se, vetem pas shlyerjes se te gjitha te drejtave te BBSH, te gjitha pasurite e tjera te Barresuara do te behen prone e disponueshme e parenduar e Barredhenesit. Barredhenesi me tej garanton se nuk ka dokumenta te negociueshem te tituje te pashlyera mbi ndonje nga Pronat e Barresuara, ose qe t'i jene premtuar apo dhene ndryshe, drejtperdrejt ose terthorazi ndonje pale te trete.

2

5 Mjetet e Sigurimit

- (1) Si mjet sigurimi per ripagimin e shumes se mbuluar nga Financimi, Barredhenesi ketu bie dakort te barrosoje per BBSH-n dhe ketu siguron BBSH-n nepermjet barresimit fillestar dhe te vazhdueshem te gjitha te drejtat, titujt dhe interesat e Barredhenesit, ne cdo rast ekzistuese ose qe do te ekzistojne ketej e tutje, ne te cilat Barredhenesi ka ose do te kete interes dhe kudo qe te jete: Te gjitha pajisjet ne te gjitha format, gjithe pjeset e tyre dhe instalimet, (secila dhe te gjitha keto pajisje, pjese dhe instalime jane "Pajisjet");

I gjithe inventari ne te gjitha format, perfshire (i) te gjitha sendet e Barredhenesit per shitje ose dhenie me qera ose per t'u furnizuar sipas kontravave, (ii) te gjitha lendet e para, gjysme te gatshme, dhe materialet e perdonura ose te konsumuara ne prodhim, paketim, transport, reklamim, shitje, dhenie me qera, furnizim ose ndryshe konsumuar ne punen e Barredhenesit (iii) te gjitha sendet ne te cilat Barredhenesi ka interes ose te drejta te cdo lloji, dhe (iv) te gjitha sendet qe i jane kthyer ose riposeduar nga Barredhenesi (i gjithe ky inventar, instalim dhe produkte qe perbejne "Inventarin");

Te gjitha dokumentat e negociueshem te pronesise (perfshire por jo kufizuar ne faturat e magazinimit, faturat e portit dhe bills of lading) leshuar nga cdo Person qe mbulon cfaredo inventari qe mbahet prej Barredhenesit (cfaredo dokumenti i negociueshem titulli qe eshte "Dokument i Negociueshem Titulli");

Te gjitha dhe cfaredo garancie (perfshire por jo kufizuar obligacione, fonde, aksione, etj) qe i perkasin Barredhenesit ose jane ne posedimin e tij, ose ne te cilat Barredhenesi ka nje interes ne mase ose te perbashket ose interesa apo te drejta te cdo lloji (te gjitha keto garanci quhen "Garancite") dhe shuma qe do te depozitohen here pas here ne llogarite e Barredhenesit ne BBSH-n ose ne ndonje banke tjeter bashke me te gjitha interesat, dividentet ose shuma te tjera cfaredo te marra nga Garancite ose shumat e depozituara nga Barredhenesi;

Barre siguruese mbi:



1. Barre Siguruese mbi 100% te kuotave qe Z. Benon Dede zoteron ne shoqerine Tirana Auto shpk me NUIS K82318007Q.

Barredhensit angazhohet te njoftoje banken nese emeton kuota gjate periudhes qe Marreveshja e Financimit dhe ato te sigurimit te Financimit jane ne fuqi. Barredhenesi angazhohet se nuk do te barrosoje dhe nenshkruaje, Marreveshje me asnje banke ose financiare, pa marre me pare pelqimin e BBSH.

Brenda dy dite pune nga data e kesaj Marreveshje, Barredhenesi do te aplikoj per regjistrimin e Barres Siguruese dhe te kesaj Marreveshje ne Qendren Kombetare te Biznesit(QKB) nepermjet depozitimit te Njoftimit te Barres ne menyre qe Barra Siguruese te regjistrohet si barre e radhes se pare te preferimit sipas parashikimeve te legjisacionit shqiptar. Barredhenesit do te njoftojne dhe do ti dergoje Barremaresit crtifikaten e kryerjes se rregjistrimit ne QKB Brenda nje dite pune nga data e marrjes se certifikatesse rregjistrimit, leshuar nga QKB (ekstrakti nga QKB)

Barredhenesi do te mbaje te dhena te sakta te Prones se Barresuar, duke pershkruar cdo lloj, tipin dhe sasine, shpenzimet e Barredhenesit per to dhe (ku eshte e mundur) listen aktuale te cmimeve te Inventarit; duke informuar me shkrim BBSH cdo muaj kalendarik per gjendjen e Prones se Barresuar edhe sikur te mos ke ndryshime dhe brenda 10 dite pune kur ka ndryshime qe ndikojne vleren e inventarit per me shume se 10% ose me shume te vleres fillestare.

(2) Barredhenesi nuk do te kete te drejte ne asnje kohe te marre financime te tjera nga BBSH dhe ne rast se shuma totale e detyrit te tij ndaj BBSH do te kaloje 33 per qind te vleres se Prones se Barresuar, Barredhenesi do te magazinoje menjehere ne BBSH garanci shtese te miratuara nga BBSH ose do t'i paguaje BBSH-se shuma te mjaftueshme per ta mbajtur te pacenuar kete marzh. BBSH do te jete vleresuesi i vetem i Pasurise se Barresuar dhe garancive te tjera per qellimin e kesaj Marreveshjeje. BBSH do te kete te drejte, ne diskrecionin e tij te vetem, te ndryshoje nga koha ne kohe nivelin e marzhit te dhene ketu.

6 Te Ardhurat nga Shitia t'i paguhen BBSH

- (1) Te ardhurat nga shitja e Pasurise se Barresuar, ne qofte se nuk shiten prej BBSH, do t'i paguhen BBSH.
- (2) (a) Nen pushtetet e BBSH dhe detyrimet e Barredhenesit qe permabhen ketu, Barredhenesi mundet, me miratimin e BBSH, te perdore Pasurine e Barresuar ne rendin e zakonshem te punes, me kusht qe, marzhi i sigurise kerkuar nga BBSH sipas Nenit 5(2) do te mbahet gjithmone plotesisht dhe te ardhurat nga shitja e Pasurise se Barresuar t'i paguhen BBSH sipas nën-nenit (1) ketu.
(b) Pavaresisht nga nën-neni (a) ketu, Barredhenesi nuk do te shese, lejoje ose disponoje ndryshe asgne nga investimet, garancite ose aksionet ne kompanite e tjera, pa patur me pare lejen me shkrim te BBSH-s.

7 Sigurimi

- (1) Barredhenesi do te siguroje ne cdo kohe dhe here pas here dhe do te mbaje te siguruar Pronen e Barresuar ne vleren e tyre te plote kunder zjarrit, goditjeve, trazirave civile dhe gjithe reziqeve te tjera, sic kerkohet nga BBSH, ne kompani sigurimi te miratuara nga BBSH, ku BBSH te jete perfituesi. Barredhenesi do t'i dorezoje BBSH nje fotokopje te polices se sigurimit ose policave te sigurimit. Ne qofte se Barredhenesi deshton ta kryeje kete sigurim ose te paguaje rregullisht primin e sigurimit ne datat e caktuara, BBSH mund t'i siguroje ato dhe/ose te paguaje primin e sigurimit dhe t'ia debitoje shpenzimet Barredhenesit. BBSH nuk do te jete persegjegje per harresen per t'i siguruar ose mos sigurimin ose mos pagimin e demeve nga ndonje kompani sigurimi (teresisht ose pjeserish).
- (2) Ne rast humbeje, shkaterrimi nga zjarri ose tjeter ose demtimi te Prones se Barresuar ose nje pjesa te saj, BBSH do te kete te drejte te rregulloje, caktoje dhe beje kompromis per cdo



A2024050620105420897

mosmarreveshje midis siguruesit dhe te siguruarit qe mund te dale prej ose ne lidhje me kete police ose keto polica dhe te marre te gjitha parate e pagueshme te sigurimit. Ne rast se BBSH nuk i merr parate e pagueshme ne lidhje me sigurimin, teresisht apo pjeserisht, per cfaredo arsy, Barredhenesi do te jete i detyruar te paguaje shumen kundrejt kerkeses.

- (3) Te gjitha shumat e parave te marra sipas nën-nenit (2) ketu, mund te zbatohen kundrejt pageses se shumes se financimit, ne alternativen e BBSH, dhe nese nje pjese e shumes se sigurimit do te mbetet ne duart e BBSH, pas nje aplikimi te tille sic u tha me lart, BBSH do te kete te drejte t'i zbatuje keto kundrejt cdo shume tjeter ose shumash parash qe mund te jene detyrime te Barredhenesit kundrejt BBSH ne cfaredo transaksiioni ose transaksionesh cfaredo. Nese, pas rregullimit te te gjitha te drejtave te BBSH kunder Barredhenesit, ndonje teprice do te mbetet, kjo teprice do te mbetet ne dispozicion te Barredhenesit nese shuma ose shumat e realizuara nga sigurimi do te jene te pamjaftueshme per te mbuluar detyrimin kundrejt BBSH, Barredhenesi eshte dakort t'i paguaje menjehere BBSH diferenca.

8 Posedimi i Prones se Barresuar

- (1) BBSH do te kete te drejte te marre posedimin, pa njoftuar me pare, dhe Barredhenesi do te jete i detyruar te jape posedimin e Prones se Barresuar qe nuk eshte ne posedimin e BBSH dhe Barredhenesi do te zbatuje te gjitha udhezimet e BBSH dhe do te jape te gjithe ndihmen e nevojshme per te vene dhe per ta mbajtur BBSH-n ne posedim ekskluziv, ruajtje dhe kontroll te Prones se Barresuar dhc ne kete menyre ky posedim, ruajtje dhe kontroll do te jete i dukshem dhe i padiskutueshem. Barredhenesi do te zbatuje menjehere dhe dorezoje te gjitha instrumentat dhe dokumentat e metejshme, dhe do te ndermarre veprime te metejshme, qe mund te jene te nevojshme ose te deshirueshme, ose qe BBSH mund te kerkoste, me qellim qe te perfeksionoje ose mbroje cdo interes garancie te dhene ose pretenduar te dhene ose per ta lejuar BBSH-n te ushtroje te drejtat e saj ketej e tutje ne lidhje me Pronen e Barresuar. Pa kufizuar vijueshmerine e per gjithshme, Barredhenesi do te (i) me kerkesen e BBSH , dorezoje dhe lere peng BBSH te gjitha notat e premtimit dhe instrumentat e tjere(perfshire ceqet) qe perbejne Pronen e Barresuar, autorizuar rregullisht dhe shoqeruar nga instrumenta rregullisht te zbatuara te transferimit ose emerimit, te gjitha me forme dhe permbytje te kenaqshme per BBSH-n, (ii) ekzekutoje dhe arshivoje deklarata financiare dhe vazhduese, ose ndryshime te tyre, dhe instrumenta dhe njoftime te tillë qe mund te jene te nevojshme ose te deshirueshme, ose qe mund te kerkohen nga BBSH per te persosur dhe ruajtur interesat e garancise se dhene ose te menduar te dhene ketu, dhe (iii) me kerkesen e BBSH, te dale dhe mbroje cdo veprim ose procedure qe mund te ndikoje titullin e Barredhenesit ose interesin e garancise se BBSH ne te gjitha ose nje pjese te Prones se Barresuar.
- (2) Barredhenesi ketu autorizon BBSH-n te arshivoje nje ose me shume deklarata financimi ose vazhdimi, dhe ndryshimet e tyre, qe lidhen me te gjithe ose pjese te Prones se Barresuar pa nenshkrimin e Barredhenesit. Barredhenesi eshte dakort qe nje kopje, nje riprodhim fotografik ose tjeter i kesaj Marreveshje ose i nje deklarate financimi e nenshkruar nga Barredhenesi do te jete e miaftueshme si nje deklarate financimi dhe mund te arshivohet si nje deklarate financimi ne cfaredo dhe te gjitha juridiksionet.
- (3) Ne rast se BBSH I ushtron te drejtat e veta sipas kushteve te nën-nenit (1) ketu, Prona e Barresuar ose nje pjese e saj nuk do te hiqet nga mjediset e Barredhenesit vecse me urdher te nenshkruar nga BBSH ose nje punonjes i saj i autorizuar per ta bere kete.

9 Shitia e Prones se Barresuar

- (1) Ne rast se Barredhenesi nuk paguan sipas kerkeses shumen e financimit ose shuma te tjera detyrim BBSH ose nese Barredhenesi nuk veren ose nuk kryen ndonje nga kushtet ketu, ose per ndonje arsy BBSH mund ta konsideroje garancine e vet ne rrezik, BBSH, do te kete te drejte por jo i detyruar, dhe pa ndikuar asnjte te drejte tjeter te BBSH, te shese ose disponoje ndryshe me ankand publik ose kontrate private ne cdo kohe, ose here pas here ne nje menyre te tillë dhe sipas kushteve te tillë qe mund t'i quaje te pershatshme pa njoftuar Barredhenesin ose pa marre pelqimin e tij, Pronen e Barresuar ose nje pjese te saj dhe te detyroje realizimin, rregullimin, berjen e kompromisit, paraqitjen per arbitrazh ose trajtimin ne cdo menyre me te drejtat e pretendimet qe lidhen me to pa qene e detyruar t'i ushtroje keto pushtete dhe pa qene per gjejgjese per ndonje humbje ne ushtrimin e tyre dhe pa ndikuar te drejtat e tjera te BBSH dhe te zbatoje te



A2024050620105420897

ardhurat neto te shitjeve kundrejt likujdimit dhe permbushjes se shumes se mbuluar nga Financimi.

- (2) Nese, pas aplikimit sic u tha me lart, do te mbetet nje pjese e te ardhurave nga shitja, BBSH do te kete te drejten t'i administroje keto kundrejt cdo shume tjeter parash qe mund te jete detyrim i Barredhenesit ndaj BBSH per ndonje transaksion tjeter ose transaksion cfaredo. Nese pas shlyerjes se te gjithe detyrimeve ndaj BBSH, do te mbetet ndonje teprice, kjo do te jete ne dispozicion te Barredhenesit por nese shuma ose shumat e marra nga te ardhurat e shitjes do jene te pamjaftueshme per te mbuluar shumat detyrim ndaj BBSH sic u tha me lart, Barredhenesi eshte dakort t'i ripaguaje menjehere diferencaen BBSH. Ne ushtimin e pushtetit te shitjes dhe disponimin e dhene ketej e tutje, BBSH do te jete i lire, ne cdo kohe dhe here pas here, ne diskrecionin e tij te plote por per riskun dhe llogarine e Barredhenesit, te hyje ne kontrata pengu, kontrata me afat dhe kontrata te tjera ne Shqiperi ose gjetke per mbrojtjen e interesave te tij si ta mendoje te arsyeshme dhe Barredhenesi do t'i paguaje BBSH cdo shume qe mund te behet e pagueshme sipas kesaj kontrate pengu, kontrata me afat ose tjeter.

10 Llogaria e Shitjes e BBSH

1 Barredhenesi ketu bie dakort te pranoje pa kushte llogarime e BBSH te kesaj shitjeje ose transaksione te tjera te nenshkuara nga cdo agjent ose oficer tjeter i autorizuar i BBSH si prove e shumave te realizuara nga shitjet ose transkcionet dhe kostot, tarifat dhe shpenzimet e kryera ne lidhje me to dhe te paguaje cdo mungese ose diferenca te treguar.

2

11 Komision I BBSH

1 Ne nje shitje me kontrate private ose ankand publik sipas klauzolave te Nenit 9 ketu, BBSH do te kete te drejten te ngarkoje dhe mbaje si pjese te shpenzimeve te kryera per te, ate komision qe BBSH do ta caktoje ne diskrecionin e tij te vetem dhe BBSH nuk do te jete perqejese t'ia llogarise kete Barredhenesit. Ky komision do te jete shtese e atij per agjentin ose te shpenzimeve te tejra ne lidhje me kete shitje. Nese te ardhurat nga shitja nuk jane te mjaftueshme per te paguar shumen e ketij komisioni, Barredhenesi do ta paguaje kete me kerkesen e BBSH.

2

12 Te drejtat e BBSH ne dorezimet e pjesshme

1 Ne rast se BBSH ushtron te drejtat e tij sipas kushteve te Nenit 8 ketu, BBSH do te jete i lire, ne diskrecionin e tij te vetem here pas here dhe ne cdo kohe, t'i dorezoje dhe/ose transferoje Barredhenesit ose ndonje personi tjeter te emeruar prej tij, te gjithe ose nje pjese te Prones se Barresuar kundrejt pageses se shumave ndaj BBSH. Cdo dorezim i pjesshem, transferim ose riparim nga Barredhenesi sic u tha me lart, ne asnje menyre nuk do te ndikoje te drejtat e BBSH sipas kesaj Marreveshjeje mbi pjesen tjeter te Prones se Barresuar. Cfaredo dorezim i pjesshem, transferim ose riparim nga Barredhenesi si me lart nuk do te ndikoje ndonje kerkese te meparshme ose mepasshme te bere nga BBSH Barredhenesit per pagimin e shumave qe mbulohen nga Financimi ose ndonje detyrim asaj ketej e tutje ose ndonje hap ose veprim per shitje, disponim ose tjeter marre ne lidhje me Pronen e Barresuar.

2

13 BBSH vepron si perfaquesues ligjor

- (1) Barredhenesi do te zbatoje detyrat e tij me efisence dhe do te furnizoje dhe verifikoje te gjitha deklaratat, raportet, llogarite, dokumentat dhe informacionin dhe do te zbatoje te gjitha dokumentat qe kane lidhje me Marreveshjen dhe do t'I dergoje njoftim debitoreve dhe paleve te treta ne menyren dhe kohen e kerkuar nga BBSH dhe do te transferoje dhe dorezoje BBSH te gjithe dokumentat relevante dhe garancite dhe do te beje gjithcka BBSH mund te kerkoste per t'i dhene efekt klauzolave te kesaj Marreveshjeje dhe Barredhenesi ketu autorizon BBSH-n, agjentet e saj dhe te emeruarit e saj si perfaquesues ligjore te dhe ne emer te Barredhenesit te bejne cfaredo qe Barredhenesit i kerkohet te beje ketej e tutje dhe ne vecanti, dhe pa ndikuar pamjen e pergjithshme, te jape/ nenshkuaje njoftime te kerkuara per transferimin e kesaj prone ne perputhje me Kodin Civil Shqiptar.
- (2) Barredhenesi ketu emeron ne menyre te pakthyeshme BBSH-n si perfaquesues ligjor te Barredhenesit me autoritet te plote ne vend te Barredhenesit dhe ne emer te Barredhenesit, qe here pas here ne diskrecionin e plote te BBSH te marre veprime dhe ekzekutoje instrumenta qe BBSH do t'i quaje te nevojshme ose te deshirueshme per te kryer qellimet e kesaj Marreveshjeje, perfshire por jo kufizuar ne:



A2024050620105420897

- (a) te kerkonte, mbledhe, padise per, marre, kombinoje, marre dhe jape mandate dorezimi dhe marrjeje parash detyrime ose ne lidhje me Pronen e Barresuar;
- (b) te marre, autorizoje dhe mbledhe drafte dhe instrumenta te tjera, dokumenta ne lidhje me klauzolen (a) me lart;
- (c) te arshivoje pretendime ose marre veprime ose procedura qe BBSH do t'i mendoje te nevojshme ose deshirueshme per mbledhjen e Prones se Barresuar ose per te ushtruar te drejtat e BBSH ne lidhje me Pronen e Barresuar;
- (d) te paguaje ose shlyeje taksa ose Liene (pervec Lieneve te lejuara nen kete Marreveshje ose Marreveshje te tjera ndermjet Barredhenesit dhe BBSH) te vena mbi ose qe kercenojne Pronen e Barresuar, ligjshmerine ose vlefshmerine e tyre dhe shumat e nevojshme per t'i shlyer ato qe caktohen nga BBSH ne diskrecionin e saj te plote, pagesa te tilla te bera nga BBSH behen detyrime te Barredhenesit ndaj BBSH, te detyrueshme dhe te pagueshme menjehere pa kerkese;
- (e) te nenshkruaje dhe perdore fatura, dokumenta transporti dhe dergimi, bills of lading, mandate magazinimi, drafte kunder debitoreve, detyrime, verifikime dhe njoftime ne lidhje me Llogarite dhe dokumenta te tjera qe lidhen me Pronen e Barresuar; dhe
- (f) ne rastin e Mospermushjes se Detyrimit dhe vazhdimit te tij, per gjithesht te shese, transferoje, lere peng, beje marreveshje mbi Pronen e Barresuar plotesisht sikur BBSH eshte pronar absolut i saj per te gjitha qellimet, dhe te beje, ne zgjedhjen e BBSH dhe me shpenzimet e Barredhenesit, ne cdo kohe dhe here pas here te gjitha veprimet qe BBSH do t'i quaje te nevojshme per te mbrojtur, ruajtur ose realizuar mbi Pronen e Barresuar dhe interesat e garancise se BBSH aty me qellim per te arritur qellimin e kesaj Marreveshjeje, ne menyre te plote dhe efektive nga Barredhenesi.

14 Administrator - Kujdestar

1BBSH do te kete te drejte te emeroje cilindo kujdestar, agjent, menaxher ose cdo person tjeter per te ushtruar te gjitha ose secilin nga pushtetet e dhena ketu BBSH referuar garancise se krijuar ketu dhe do te kete te drejte te marre nga Barredhenesi shperblimin dhe/ose shpenzimet e ketij marresi, agjenti, menaxheri ose personi tjeter si me lart. BBSH nuk do te jete perjegjes dhe do te kete te drejte te demshperblehet nga Barredhenesi per dhe ne lidhje me te gjitha aktet, mosveprimet, neglizhencen ose gabimet (e ndodhura ne rrjedhen normale te punes ose jashte) e ketij marresi, agjenti, menaxheri ose personi dhe te gjitha humbjet, demtimet, pretendimet, kerkesat, shpenzimet e pershatshmerise dhe shpenzimet e bera ne lidhje me keto.

2

15 Garancia e BBSH nuk Ndikohet

1Asgje e permabjatur ketu nuk do te ndikoje te drejtat e BBSH ne lidhje me garancite e tashme apo te ardhme, detyrimet ose mandatet per cfaredo detyrimi te Barredhenesit kundrejt BBSH pavaresisht nga kjo Marreveshje.

2

16 Garancia e vlefshme per kerkesa te tjera

1Garancia e krijuar ketu, subjekt i te drejtave te BBSH, do te jete e vlefshme per BBSH-n si garanci per te gjitha shumat e parave, llogarite, detyrimet e tanishme ose te ardhme, te kushtezuara ose te varura, te maturuara ose jo, te detyrueshme ose qe do te behen te detyrueshme, nga Barredhenesi kundrejt BBSH me nje tjeter ose si garant ose ne ndonje tjeter cilesi cfaredo per te gjitha kerkesat dhe shpenzimet e BBSH kundrejt Barredhenesit ne cfaredo llogarie, gjithmone me kusht qe, nese dhe kurdo qe garancia e krijuar ketu do te mbahet nga BBSH per detyrimin e Barredhenesit per detyrimet e cilesdo pale te trete ndaj BBSH, ajo do te jete e lire pa njoftuar Barredhenesin, te veproje sikur Barredhenesi te ishte perjegjesi kryesor.

2

17 BBSH nuk eshte perjegjes per gjendjen e Sendeve

1BBSH nuk do te jete ne asnjë menyre perjegjese ne lidhje me sasine/ cilesine ose gjendjen finale te Sendeve ose per humbjet ose shkaterrimin ose demtimin e tyre prej vjedhjes, zjarrit, trazirave, goditjeve, lufte civile ose tjeter, cilatdo qofshin rrethanat nen te cilat humbja, shkaterimi ose demtimi mund te ndodhin perfshire veprime, harresa, neglizhencë ose mungese te BBSH ose ndonjerit prej oficereve ose agjenteve te saj.

2

18 Demshperblimi i BBSH prej Barredhenesit

1Barredhenesi do te demshperbleje dhe mbaje te demshperbyler BBSH-n kundrejt gjithe humbjeve, demtimeve, kerkesave dhe shpenzimeve ne lidhje me Pronen e Barresuar mbajtur nga ose bere kunder BBSH.



A2024050620105420897

2

19 Titulli i Barredhenesit

1Barredhenesi ketu bie dakort me BBSH-n se ai ka te drejta te plota, te pacenuara per te lene peng, siguroje ose barresoje Pronen e Barresuar dhe garanci te tjera sic u tha me lart nepermjet barresimit te pare dhe sigurimit vazhdues dhe deklaron se keto jane dhe do te jene te lira nga cdo pretendim nepermjet lienis, barres, hipotekes ose tjeter.

20 Kostot

1Barredhenesi do te jete perqejges per te gjitha kostot, tarifat dhe shpenzimet (si ndermjet konsulentit ligjor dhe Barredhenesit) e kryera nga BBSH gjate negocimit, ekzekutimit ose venies ne efekt te kesaj Marreveshjeje ose ne lidhje me ushtrimin e ndonje pushtet te shitjes ose veprim apo ceshtje tjeter qe del nga kjo Marreveshje ose aksidentale dhe keto do t'i ngarkohen Barredhenesit.

21 Garanci Vazhduese

1Kjo Marreveshje do te veproje si nje garanci vazhduese per shumen e mbuluar nga financimi dhe te gjitha shumat e detyruara nga Barredhenesi BBSH-se dhe nuk duhet te konsiderohet e perfunduar me pagimin e plete te detyrimeve ose ne nje bilanc te pergithshem llogarish qe Barredhenesi eshte ne kredi me BBSH-n, por do te vazhdoje te veproje ne lidhje me transaksionet e metejshme.

22 Njoftimi

1Cdo njoftim nepermjet kerkeses ose tjeter ketej e tutje qe do te jepet nga BBSH Barredhenesit mund te lihet ne vendin e fundit te njohur te punes ne Tirane te Barredhenesit adresuar Barredhenesit ose derguar me poste atij si me lart dhe nese cohet me poste, do te konsiderohet i dhene ne kohen normale te postimit dhe per dhenien e ketyre njoftimeve me poste, do te jete e mjaftueshme te provohet se zarfi qe permban njoftimin u postua dhe nje vertetim i nenshkruar nga nje drejtues lokal ose agjent i BBSH se zarfi u postua, do te jete bindes. Nese Barredhenesit nuk mund t'i jepet nje njoftim i tille, nese ky do te botohet ne nje gazete qe qarkullon ne zonen e zyrate te BBSH, do te quhet i dhene efektivisht dhe i marre ne daten kur del kjo gazete.

2

23 Caktimi i shumave te mbuluara nga Financimi

1Barredhenesi ketu eshte dakort se BBSH do te kete te drejte te caktoje ose transferoje te drejtat e tij per te marre shumat e mbuluara nga financimi, teresisht ose pjeserisht, dhe do te jete e autorizuar t'i beje te njohura te dhena te tilla lidhur me shumat e mbuluara nga financimi dhe garancite, si ta mendoje BBSH te nevojshme.

2

24 Zbatimi i Garancise dhe Trajtimet

1Nese ka ndodhur ose vazhdon Rasti i Mospermbushjes se Detyrimit, BBSH mund te ushtroje ne lidhje me Pronen e Barresuar pervec te drejtave te tjera te dhena ketu ose gjetke, te gjitha te drejta dhe trajtimet e nje pjese te siguruar ne mospermbushje detyrimi sipas ligjit te zbatueshem, dhe gjithashtu (a) Barredhenesi ketu autorizon shprehimisht BBSH-n te terheqe fonde nga te gjitha llogarite nga bankat e Barredhenesit; (b) perpara disponimit te Prones se Barresuar, te ruaje, perpunoje, riparoje ose rikondicionoje Pronen e Barresuar ose ta perqatise ndryshe ate per disponim sipas preferencave te BBSH, (c) te marre posedimin e mjediseve te Barredhenesit dhe t'i perdore ato dhe pajisjet e tij per te plotesuar punen ne proces, duke ndermanar veprimet e pershkruara ne klauzolen e veprimeve (b) dhe te mbledhe detyrimet e siguruara, dhe (d) pa njoftuar pervec sa eshte specifikuar me lart, te shese Pronen e Barresuar ose pjese te saj ne nje ose me shume pjese ne shitje private ose publike, ne zyrat e BBSH ose gjetke, per cash, me kredi ose dorezim te ardhshem, ne kohen dhe cmimiet qe BBSH do t'i quaje komersialisht te arsyeshme. BBSH mund te jete bleresi i nje pjese ose gjithe Prones se Barresuar ne keto shitje dhe BBSH do te kete te drejte, per qellimin e drejtimit ose negocimit ose pagese se cmimit te blerjes per te gjithe ose nje pjese te Prones se Barresuar te shitur ne shitje publike, te perdore dhe zbatoje pjese te Detyrimit si kredi ne llogarine e cmimit te blerjes per te gjithe ose nje pjese te Prones se Barresuar te pagueshme nga BBSH ne keto shitje. Cdo bleres ne keto shitje do ta mbaje pronen e shitur absolutisht te lire nga pretendime ose te drejta te Barredhenesit, dhe Barredhenesi ketu heq dore (deri ne kufirin e lejuar nga ligji) nga te gjitha te drejtat e kompensimit dhe/ ose vleresimit qe ai mund te kete here pas here sipas ndonje rregulli, ligjt ose statuti ekzistues ose te ardhshem. Barredhenesi eshte dakort qe, aq sa njoftimi per shitje do te kerkohet nga ligji, nje njoftim dhjete ditor Barredhenesit mbi kohen dhe vendin e shitjes perpara se ajo te kryhet, eshte nje njoftim i arsyeshem per te. BBSH nuk do te jete i detyruar te beje shitje te Prones se Barresuar edhe pse njoftimi per shitje mund te jete dhene. BBSH mund te njoftojte per shitje private ose publike duke njoftuar per vendin dhe kohen e caktuar, dhe kjo shitje mund te kryhet pa njoftim te metejshem ne kohen dhe vendin e njoftuar. Barredhenesi ketu heq dore nga pretendimet qe cmimi i shitjes se Prones se Barresuar ose nje pjese te saj te shitur ne nje shitje private ishte me i vogel se cmimi qe mund te



A2024050620105420897

ishte marre ne nje shitje publike, edhe nese BBSH pranon oferten e pare te marre dhe nuk ia ofron Pronen e Barresuar me shume se nje kerkuesve. Nese te ardhurat nga shitja ose nje disponim tjeter i Prones se Barresuar jane te pamjaftueshme per te paguar te gjithe Detyrimin, Barredhenesi do te jete perjegjes per mungesen dhe shpenzimet avokatore per mbledhjen e kesaj mungese (difference). Barredhenesi ketu angazhohet te mos marre veprime ligjore kunder BBSH, per asnjë arsyé, ne kohen qe kjo Marreveshje eshte ne fuqi dhe as pas skadimit te afatit te kesaj Marreveshje per ceshtje lidhur me vete Marrevshjen.

2

25 Te Pergjithshme

- 1- Nese ne ndonje kohe Barredhenesi do te kryeje veprim falimentimi ose behet insolvent ose nese ekzekuton ndonje dokument ose rregullim ose bashkepunim me nje ose me shume prej kreditoreve te tij, do te jete e ligjshme per BBSH-n te shese menjehere ose disponoje ndryshe me kontrat eprivate ose ankand publik, menjehere, ne cdo kohe pa njofstuar Barredhenesin dhe pa ndikuar te drejtat e tjera te BBSH sipas kesaj Marreveshjeje ose sipas ligjit, cfaredo ose te gjithe Pronen e barresuar si ne grupe dhe/ose vecmas dhe te administroje te ardhurat e marra nga shitjet per ose ne zvogelim te bilancit te detyrimit ndaj BBSH.
- 2- Barredhenesi do te kryeje punen e tij me eficence dhe do ta furnizoje BBSH-n me deklarata mujore te verifikuara te Prones se Barresuar bashke me raporte ose informacione te tjera sic mund te kerkohet nga BBSH. Barredhenesi do t'i jape te gjitha lethesite perfaqesuesve te BBSH per ta lejuar te inspekoje Pronen e Barresuar si dha kur ta kerkoje.
- 3- Gjate kohezgjatjes se Garancise, Barredhenesi do t'i paraqese BBSH nje bilanc dhe nje llogari fitim-humbje me rastin me te pare cdo vit te vertetuar nga auditoret per momentin te Barredhenesit dhe te miratuar nga BBSH dhe gjithashtu, here pas here, te paraqese infomacion te tille mbi asetat dhe detyrimet e Barredhenesit sic mund te kerkonte ne menyre te arsyeshme BBSH, perfshire informacionin financier gjashte mujor.
- 4- Barredhenesi nuk do te krijoje asnjë hipoteke, barre, lien ose cenim tjeter mbi Pronen e Barresuar dhe gjithe gjendjen e saj apo te ndonje pjese, pa marre me pare miratimin me shkrim te BBSH, ne shtese te barreve ekzistuese dhe krijuar ne favor te BBSH, Barredhenesi nuk do te lejoje kete garanci krijuar ketu te demtoje ose ndikoje ose te demtohet nga ndonje garanci tjeter per para te marra borxh nga Barredhenesi BBSH te cilat BBSH tanë i mban ose mund t'i mbaje here pas here nga Barredhenesi.
- 5- Nese BBSH nuk ushtron te drejtat e veta ketej e tutje ose ne rast thyerjeje ose moszbatimi prej Barredhenesit te ndonje nga kushteve qe permbahen ketu, mosveprimi ose harresa e BBSH nuk do te trajtohen si heqje dore ose braktisje e ketyre te drejtave.
- 6- Amendamente, modifikime, perfundim ose heqje dore prej ndonje klauzole te kesaj Marreveshjeje dhe pelqim per dalje nga Barredhenesi prej tyre nuk do te jene efektive nese keto nuk behen me shkrim dhe nenshkruehet nga BBSH dhe, ne rast ndryshimesh, kjo heqje dore ose pelqim do te jete efektive vetem ne ate instance te vecante dhe per qellimin e vecante per te cilin u dha.
- 7- Ne rast se ndonje klauzole ose detyrim i kesaj Marreveshjeje do te jene te pavlefshme sipas juridikzionit, vlefshmeria, ligjshmeria dhe zbatimi i klauzolave dhe detyrimeve qe mbeten nuk do te demtohen ose dobesohen ne asgne menyre.
- 8- Te gjitha te drejtat e BBSH sipas kesaj Marreveshjeje, te gjitha interesat e garancive te krijuara ketu dhe te gjitha detyrimet e Barredhenesit ketej e tutje do te jene absolute dhe te pakushtezuara dhe vlefshmeria dhe ekzistencia e tyre Jane autonome dhe te pavarura nga Marreveshje te tjera midis Barredhenesit dhe BBSH. Te drejtat e mesiperme, interesat e garancive dhe detyrimet do te mbeten te vlefshme dhe ekzistente pavaresisht nga ndryshime qe mund te behen mbi kohen, menyren dhe vendin e pageses se Detyrimit.
- 9- Pavaresisht nga c'mund te jete e kundert ketu, (a) Barredhenesi do te mbeten perjegjes nen cdo kontrate dhe marrevshje perfshire ne Pronen e Barresuar, ne masen e caktuar aty, per te kryer te gjitha detyrat e tij dhe detyrimet aty e tutje ne te njeften mase sikur kjo Marreveshje te mos isht zbatuar, (b) ushtrimi prej BBSH i te drejtave nen kete Marrevshje nuk do ta shkarkoje Barredhenesin nga detyrat dhe detyrimet e tij nen kontratat dhe marreveshjet e perfshira ne Pronen e Barresuar, dhe (c) BBSH nuk do te kete asnjë detyrim nen kontratat dhe marreveshjet e perfshira ne Pronen e Barresuar per shkak te kesaj Marreveshjeje, dhe nuk do te jete i detyruar te kryeje asnjë detyrim ose detyre te Barredhenesit ose te ndermarre veprime per te mbledhur ose zbatuar te drejtat per pageset caktuar nga kjo Marreveshje.
- 10- Titujt e seksioneve dhe nenseksioneve ne kete Marreveshje jane perfshire vetem per lehtesi referimi dhe nuk perbejne pjese te kesaj Marreveshjeje per ndonje qellim tjeter ose per t'i dhene efekt thelbesor.



A2024050620105420897

Kjo marreveshje perbehet nga 8 faqe dhe nenshkruehet ne 3 kopje te njejtta, nga nje per secilen pale dhe nje per noterin.



BARREMARRESI

Bank e Bashkuar e Shqipërisë SH.A.

Ilir Cekiri Alketa Martini



BARREDHENESI

Benon Dede

Benon Dede

Alma Dede

Alma Dede

